



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM
Nr. 25 Datë 14.04.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E INVESTIMEVE PËR GRANTET KONKURUESE
PËR VITIN 2010**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban e Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës, "Për përcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitin 2010", mbështetur në :Ligji nr. 8652 dt.31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore " neni 32 pika dh ,ligji 10190 dt.26.11.2009 " Për buxhetin e vitit 2010", Udhëzimin Nr.1 datë 21.01.2010 " Për zbatimin e Buxhetit për Vitin 2010", ligji nr. 9936 dt.26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë " dhe ligji nr. 8399 dt.09.09.1998 " Për buxhetin lokal ", në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

- I. Të miratojë prioritetet e investimeve për Grantet Konkuruuese për vitin 2010, si vijon :

Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës:

- | | |
|--|-----------------|
| 1. Ndërtim shkolle e re e mesme me fondin prej | 100.000.000 lek |
| 2. Shtesë shkolla "Mësonjtore" me fondin prej | 35.000.000 lek |
| 3. Shtesë shkolla "Sotir Gurra" me fondin prej | 40.000.000 lek |

Për Ministrinë e Brendshme:

- | | |
|---|-----------------|
| 1. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 15 me fondin prej | 25.000.000 lek |
| 2. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 15/1 me fondin prej | 40.000.000 lek |
| 3. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 16 me fondin prej | 32.000.000 lek |
| 4. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 16/1 me fondin prej | 25.000.000 lek |
| 5. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 17 me fondin prej | 40.000.000 lek |
| 6. Sistemim rrugë e lulishte tek blloku i banimit lagja 17/1 me fondin prej | 10.000.000 lek |
| 7. Sistemim rrugë e trotuare Rr. "Stefi Lino", me fondin prej | 15.000 000 lek. |
| 8. Rikonstruksion i rrugës " Nënë Tereza" e "Avni Rustemi" me fondin prej | 20.000.000 lek |
| 9. im Ndriçimi i stadiumit "Skënderbeu", me fondin prej | 10.000.000 lek |

- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projekteve në Infrastrukturë, Drejtoria e Financës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

GJERGJI PENDAVINJI